



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2881 prot.

Tiranë më, 26.10.2018

## UDHËZIM I PËRGJITHSHËM

Nr. 04, datë 26.10.2018

### PËR PËRGJIMET

#### *Me synim, për të unifikuar:*

- mënyrën e realizimit të përgjimit, si mjet i kërkimit të provës, duke garantuar liritë dhe të drejtat e njeriut;
- rregullat për lëvizjen, regjistrimin, ruajtjen e sekretit dhe të dokumentacionit të dalë nga procesi i përgjimit, si dhe ndalimin e publikimit të tij;
- mënyrën e asgjësimit të materjaleve të përgjimit;

Në mbështetje të nenit 38 pika 2 germa "b", "j", 46 e vijues të ligjit nr. 97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", nenit 221 e vijues të Kodit të Procedurës Penale i ndryshuar dhe nenin 23 të ligjit nr.9157 datë 04.12.2003 "Për përgjimin e komunikimeve elektronike" i ndryshuar,

### UDHËZ O J:

#### **Neni 1**

#### **Përkufizime**

1. "Sistemi i përgjimit të komunikimeve elektronike" janë pajisjet e përgjimit që ndodhen të instaluar në vendin e caktuar në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme<sup>1</sup>.

<sup>1</sup> Shih, neni 38 pika 2 germa "j" e ligjit nr.97/2016

2. **Format e tjera të përgjimit**” mund të kryhen vetëm me anën e pajisjeve të instaluar në vende të caktuara, të autorizuar dhe të kontrolluara nga prokurori.

3. **“Material i përgjuar”** është çdo material i regjistruar në audio, kompjuter/server apo letër me anë të procesit të përgjimit, si dhe çdo fragment (pjesë e shkëputur), kopje e pjeshme ose përmbledhje e materialit të identifikuar si produkt i procesit të përgjimit procedural penal.

4. **“Parimi i proporcionalitetit”** është ballancimi i të drejtës ndërmjet interesit të përgjithshëm në ndjekjen penale në një çështje dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të individit. Në respektimin e këtij parimi, prokurori, në çdo rast, duhet të shqyrtojë dhe vlerësojë nëse masa e marrë prej tij ose masa që ai i kërkon gjykatës është në proporcion me objektivin që synohet për të arritur me anë të përgjimit.

5. **“Vende private”**, konsiderohen vendet ku personit i garantohet e drejta e jetës private, e cila nënkupton “të drejtën për të jetuar ashtu siç do vetë personi në të gjitha situatat, pa iu ekspozuar publicitetit për çdo gjë që ka të bëjë me shëndetin e personit, me bindjet e tij filozofike, fetare, morale, me jetën familjare dhe sentimentale, me lidhjet miqësore, si dhe me jetën profesionale dhe materiale”, (koment i nenit 8 të Konventës Evropiane “Për liritë dhe të drejtat themelore të njeriut”).

6. **“Vende publike”**, është një hapësirë publike në të cilën ka akses kushdo, pa asnjë formalitet, duke qenë një hapësirë që përdoret me një qëllim të posaçëm ose një qëllim kryesor ose vendi i lirë nga e drejta dhe fakti për të gjithë ose për një numër të papërcaktuar personash.

## Neni 2

### Garancitë e komunikimit dhe objektivat e përgjimit

1. Liria dhe fshehtësia e korespondencës ose e çdo mjeti tjetër komunikimi janë të garantuara<sup>2</sup>. Kufizimi i kësaj të drejte<sup>3</sup> bëhet për të mbrojtur interesat publike ose për të mbrojtur të drejtat e personave të tjerë, duke respektuar parimet e nevojshmërisë, proporcionalitetit, ruajtjes së sekretit dhe objektivitetit në kryerjen e tij.

2. Përgjimi - ndërhyrja e fshehtë për të kapur, dëgjuar dhe regjistruar përmbajtjen e komunikimit dhe të dhëna që lidhen me të, ndërmjet pikës së nisjes dhe pikës së mbërritjes - si metodë e posaçme hetimore të përdoret si një mjet i efektshëm për kërkimin e provës, duke plotësuar kushtet e parashikuara në ligj<sup>4</sup>.

<sup>2</sup> Shih nenin 36 të Kushtetutës

<sup>3</sup> Shih, po aty nenin 17 i Kushtetutës dhe nenet 221-226 të K. Pr. Penale.

<sup>4</sup> Shih nenin 221 e vijues i K. Pr. Penale

3. Përgjimet e komunikimeve elektronike, ambientale ose në forma të tjera të kryhen në kushte sa më të natyrshme, me synim për të rritur efektivitetin e këtij mjete për sigurimin e provave, identifikimin e veprimtarisë kriminale dhe të autorëve të saj, si dhe vënien e tyre para drejtësisë.

### **Neni 3**

#### **Kushtet për të autorizuar përgjimet**

1. Përgjimi i komunikimeve elektronike të një personi, të një numri telefoni me telefon, faks kompjuter ose me mjete të tjera të çdo lloji, përgjimi i fshehtë me mjete teknike i bisedave në vende private, përgjimi me audio dhe video në vende private, lejohen vetëm kur procedohet:

a) për krimet e kryera me dashje, për të cilat parashikohet denim me burgim jo më pak, në maksimum, se shtatë vjet;

b) për çdo vepër penale me dashje kur kryhet me anën e mjeteve të telekomunikimit apo përdorimit të teknologjive informatike ose telematike.

c) për veprat penale të parashikuara nga shkronja "a", paragrafi 1, i nenit 75/a, të këtij Kodi.

2. Regjistrimi i fshehtë fotografik, filmik ose me video i personave në vende publike dhe përdorimit pajisjeve gjurmuese të vendndodhjes lejohen vetëm kur procedohet për vepra të kryera me dashje, për të cilat parashikohet denim me burgim jo më pak, në maksimum, se tre vjet.

3. Përgjimi mund të urdhërohet kundër:

a) të dyshuarit përkryerjen e një vepre penale;

b) personit që dyshohet se merr ose transmeton komunikime nga i dyshuari;

c) personit që merr pjesë në transaksione me të dyshuarin;

ç) personit, vëzhgimi i të cilit mund të çojë në zbulimin e vendndodhjes ose të identitetit të tëdyshuarit.

4. Rezultati i përgjimit është i vlefshëm për të gjithë komunikuesit.

5. Përgjimi parandalues rregullohet me ligj të veçantë. Rezultatet e tij nuk mund të përdoren si provë.

### **Neni 4**

#### **Kërkesa dhe kushtet për autorizimin e përgjimit**

1. Përgjimi për rastet e lejuara në nenin 221, pika 1, kërkohet nga prokurori vetëm kur sigurohet për ekzistencën e kushteve bazë që janë:

a) Përgjimi është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara;

b) Kur në ngarkim të personit ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se ka kryer ose është në kryerje e sipër të një vepër penale që përmbush kushtet për tu autorizuar përgjimi sipas nenit 3 të këtij udhëzimi.

2. Vetëm konstatimi i ekzistencës njëkohësisht të këtyre kushteve mund të vlerësojë të ligjshëm lëshimin e autorizimit për përgjim.

## **Neni 5**

### **Kompetenca për të autorizuar përgjimet**

Kompetenca e përgjimit, në kushte normale, gjatë hetimeve paraprake, realizohet, si më poshtë:

1. Me kërkesën e prokurorit, për rastet e lejuara në paragrafin 1, të nenit 221, gjykata autorizon përgjimin me vendim të arsyetuar, kur ai është i domosdoshëm për vazhdimin e hetimeve të filluara dhe kur në ngarkim të personit ekziston një dyshim i arsyeshëm dhe i bazuar në prova se ka kryer një vepër penale.

2. Kur ka arsye të bazuara për të menduar se nga vonesa mund t'i vijë një dëm i rëndë hetimeve dhe plotësohen kushtet e paragrafit 1, të këtij neni, prokurori vendos përgjimin me akt të motivuar dhe njofton gjykatën menjëherë, por jo më vonë se njëzet e katër orë nga marrja e vendimit. Kur vleftësimi nuk bëhet në afatin e caktuar, përgjimi nuk mund të vazhdojë dhe rezultatet e tij nuk mund të përdoren.

3. Kur njëri nga dy personat që do të përgjohen është I gatshëm të kryejë dhe të regjistrojë veprimin përkatës, sipas marrëveshjes me oficerin e policisë gjyqësore, veprimi lejohet me autorizim të prokurorit.

4. Në rastet e parashikuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, gjykata merr vendim të arsyetuar në dhomë këshillimi, brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës së prokurorit. Kundërvendimit që refuzon kërkesën për përgjim mund të bëhet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit brenda 24 orëve. Gjukata e apelit shqyrton ankimin brenda 48 orëve nga marrja e akteve. Paraqitja e kërkesës për vleftësimin e përgjimit nuk shkakton ndërprerjen e tij.

5. Vendimi për përgjimin tregon mënyrën e kryerjes dhe kohëzgjatjen e veprimeve, e cila nuk mund t'i kalojë pesëmbëdhjetë ditët. Ky afat, me kërkesë të arsyetuar të prokurorit, mund të zgjatet nga gjykata sa herë është e nevojshme, për një periudhë prej 15 ditësh, kur ekzistojnë kushtet e parashikuara në paragrafin 1 të këtij neni, dhe rezultatet e përgjimit diktojnë nevojën e zgjatjes së afatit.

6. Në vendimin e gjykatës për përgjimin e fshehtë fotografik ose me video, ose për përgjimin e bisedave në vende private mund të autorizohet oficeri i policisë gjyqësore ose specialisti i

kualifikuar për të hyrë në këto vende, në mënyrë të fshehtë, duke vepruar në përputhje me vendimin. Ky autorizim duhet të zbatohet brenda 15 ditëve.

7. Në regjistrin që mbahet në prokurori shënohen aktet që urdhërojnë, autorizojnë, vleftësojnë ose zgjasin përgjimet, si dhe fillimin e mbarimin e veprimeve të çdo përgjimi.

8. Në rastet e parashikuara nga neni 221, paragrafi 2, veprimi autorizohet nga prokurori.

## **Neni 6**

### **Kërkimi i personit që nuk gjindet**

1. Përgjimi i bisedave telefonike dhe formave të tjera të komunikimit mund të aplikohet edhe ndaj personit të cilit i është marrë masa e sigurimit parashikuar nga nenet 233, 235, 237 dhe 238 të Kodit të Procedurës Penale, ose dënuar me burgim e nuk gjendet dhe gjykata ka deklaruar ikjen e tij.

2. Për të lehtësuar kërkimin e personit të ikur, mbi kërkesën e prokurorit gjykata mund të urdhërojë përgjimin e komunikimeve elektronike<sup>5</sup>.

## **Neni 7**

### **Veprimet e përgjimit**

1. Veprimet e përgjimit mund të kryhen vetëm me anën e pajisjeve të instaluar në vende të caktuara, të autorizuar dhe të kontrolluara nga prokurori.

2. Kryerja e përgjimit dhe procesverbalet e transkriptimit bëhen nga oficerë të policisë gjyqësore, nën drejtimin dhe kontrollin e prokurorit të çështjes.

3. Prokurori i prokurorisë kompetente, me akt zyrtar, bashkëshoqëron dhe komunikon vendimin e gjykatës në strukturën e përgjimit të komunikimeve elektronike pranë Prokurorisë së Përgjithshme për ekzekutimin e tij.

4. Kur ka dyshime të bazuara dhe të arsyetuara se njëri nga kushtet e përgjimit nuk ekziston më, organi procedues njofton menjëherë prokurorin, i cili vlerëson dhe urdhëron ndalimin e përgjimit dhe vë në dijeni gjykatën, kur urdhri është dhënë nga gjykata.

5. Kopja e urdhërit për ndalimin e përgjimit menjëherë i dërgohet Strukturës së Përgjimit të Komunikimeve Elektronike përkatëse.

6. Me marrjen e njoftimit për ndalimin e përgjimit, administratori i Sistemit të Përgjimit, menjëherë, ndërpret përgjimin.

<sup>5</sup> Shih nenin 247 të K.Pr.Penale

7. Komunikimet e përgjuara regjistrohen dhe për veprimet e kryera mbahet procesverbal.

## **Neni 8**

### **Regjistri i përgjimit.**

1. Në Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë dhe në Strukturën e Përgjimit të Komunikimeve Elektronike të mbahet një regjistër i unifikuar i emërtuar “Regjistri për Përgjimet”.

2. Personi i ngarkuar për administrimin e këtij regjistri, mban sipas renditjes kronologjike të tyre, gjithë aktet, vendimet ose urdhërat, me të cilat është autorizuar, vlerësuar ose zgjatur afati i përgjimeve, ndaluar përgjimi dhe kohën e fillimit dhe të përfundimit të çdo përgjimi<sup>6</sup>.

3. Regjistri duhet të plotësohet në kohë dhe me saktësi në të gjithë ekstremitetet e tij, për të shmangur abuzimet dhe pavlefshmëritë që mund të ngrihen për këtë shkak nga palët e interesuara.

## **Neni 9**

### **Procesverbali i transkriptimit**

1. Në përfundim të procesit të përgjimit, sipas afateve të përcaktuara, oficerët e policisë gjyqësore bëjnë transkriptimin në procesverbal të komunikimeve të përgjuara. Transkriptohet përmbajtja e bisedave që janë regjistruar<sup>7</sup>.

2. Transkriptimi që bën oficeri i policisë gjyqësore i specializuar, duhet të jetë i detajuar që të ndihmojë për të kuptuar bisedën që është dëgjuar, duke e shkruar siç është dëgjuar si dhe regjistrimin në CD-DVD.

3. Procesverbali i transkriptimit dhe CD-DVD përkatëse me një akt zyrtar të Strukturës së Përgjimit të Komunikimeve Elektronike i dërgohet menjëherë prokurorisë përkatëse.

4. Në hartimin e procesverbalit, duhet të tregohet kujdesi i duhur, për të fiksuar:

a) Në pjesën hyrëse tregohet:

- vendi, data dhe personi, oficeri i policisë gjyqësore, që ka kryer transkriptimin;

- numri dhe data e vendimit që ka autorizuar përgjimin dhe baza ligjore e veprimit të

fiksimit në procesverbal;

- ambienti ose telefoni stacionar, celular a në rrjetë ose mjete të komunikimit të përgjuar;

- data dhe ora e fillimit dhe e ndërprerjes së përgjimit;

- mënyra e kryerjes së regjistrimit të bisedave ose komunikimeve.

Në pjesën përshkuese tregohet:

<sup>6</sup> Shih, po aty, nenin 222 pika 5;

<sup>7</sup> Shih po aty, nenin 223 pika 2.

- përmbajtja e bisedave që janë regjistruar, me detajimet e nevojshëm e që ndihmojnë për të kuptuar bisedën që është dëgjuar;

- bisedat e veçanta që janë përgjuar, duke respektuar rendin kronologjik, kohën e kryerjes së tyre dhe emërtimi e pajisjes (CD, DVD, etj) ku ato janë regjistruar;

- inicialet e personave të njohur objekt përgjimi dhe për bashkëbiseduesit;

- biseda duhet të shkruhet siç është dëgjuar, me difektet në shqiptim, etj. Kjo është shumë e rëndësishme dhe lidhet me objektivitetin e transkriptimit.

b) Në pjesën e përfundimit, tregohet;

- përshkrimi i pajisjes (CD, DVD, etj) ku ato janë regjistruar që u transkriptuan;

- ora e fillimit dhe e përfundimit të transkriptimit dhe nënshkrimi.

5. Procesverbalet dhe regjistrimet i dorëzohen menjëherë prokurorit dhe brenda pesë ditëve nga mbarimi i veprimeve ato depozitohen në sekretari bashkë me aktet që kanë urdhëruar, autorizuar, vleftësuar dhe zgjatur përgjimin.

6. Në rastet kur nga depozitimi i akteve në sekretari mund të dëmtohen hetimet dhe mbi kërkesën e prokurorit gjykata autorizon që të shtyjë depozitimin deri në përfundimin e hetimeve paraprake, procesverbali dhe regjistrimet administrohen në fashikullin e prokurorit.

7. Në rastet kur gjykata nuk pranon kërkesën e prokurorit për të shtyrë depozitimin dhe ai vlerëson se depozitimi në sekretari dëmton vazhdimësinë e hetimeve, bazuar në nenin 279<sup>8</sup> të K.Pr.Penale prokurori me vendim të arsyetuar urdhëron ndalimin e publikimit të përmbajtjes së procesverbaleve dhe regjistrimeve të përgjimit deri në përfundim të hetimeve.

8. Mbrojtësit dhe përfaqësuesit e palëve lajmërohen menjëherë sipas rastit, si për depozitimin në sekretari dhe për të drejtën që kanë për të shqyrtuar aktet e për të dëgjuar regjistrimet, ashtu dhe për ndalimin<sup>9</sup> e publikimit të tyre deri në përfundim të hetimeve.

9. Procesverbalet e transkriptimeve futen në fashikullin e gjykimit<sup>10</sup> bashkë me vendimin<sup>11</sup> e prokurorit që ka urdhëruar ndalimin e publikimit të përmbajtjes së tyre dhe/ose detyrimin për të ruajtur sekretin.

## Neni 10

### Ndihma e eksperteve të fushave përkatëse

<sup>8</sup> Shih nenin 279 pika 3 “Detyrimi për ruajtjen e sekretit” në lidhje me nenin 103 “Ndalimi i publikimit të aktit” pikat 1, 2 të K.Pr.Penale dhe nenin 295/a § 3 “Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete” të K.Penal

<sup>9</sup> Shih po aty nenin 279 pika 3.

<sup>10</sup> Shih po aty nenin 223 pika 5 dhe nenet 331 e 332/ë germa “F”

<sup>11</sup> Shih po aty nenin 279 pika 3.

1. Në hetimet paraprake kur ka pretendime për vertetësinë e rezultateve të përgjimit, prokurori mund të kërkojë ndihmën e eksperteve të fushave përkatëse me synim:

- a) Për përcaktimin e seksit;
- b) Për përcaktimin nëse zëri është origjinal apo i manipuluar;
- c) Për identifikimin e personit në bazë të zërit dhe të folurit;
- ç) Për kthimin e bisedave të bëra në gjuhë të huaj, etj.

## **Neni 11**

### **Rregullat për ruajtjen e sekretit të përgjimit**

1. Të gjithë aktet procedurale penale, pajisjet/regjistrimet (CD, DVD, etj), regjistrat dhe shkresat përcjellëse që lidhen me përgjimet janë dokumenta "Sekret hetimor", deri në momentin kur u bëhen të njohura mbrojtësve dhe përfaqësuesit të palëve.

2. Oficerët e policisë gjyqësore të Strukturës së Përgjimit të Komunikimeve Elektronike, krahas detyrimit për përgatitjen në kohë të transkripteve të shkruara të materialit të përgjuar, duhet të garantojnë ruajtjen e sekretit dhe dërgimin e menjëhershëm të tyre subjektit që ka kërkuar përgjimin.

3. Numri i personave, të cilët mund të njihen me materialin e përgjuar duhet të jetë i kufizuar dhe secili person të nënshkruaj në regjistër se është njohur me aktin/materjalin përkatës.

4. Materiali i përgjuar nuk duhet t'i vihet në dispozicion asnjë personi, i cili nuk ka kërkesë zyrtare ose nuk është i autorizuar për të marrë këtë informacion.

5. Oficeri i policisë gjyqësore kërkesat/aktet e lidhura me përgjimin të klasifikuara «sekret hetimor», i mbyll në zarf të vulosur ku shënon ekstremitetet e kërkesës/aktit (nr.prot, datën dhe prokurorit që i drejtohet) dhe nëpërmjet sekretarisë e dëgon në prokurorinë përkatëse.

6. Sekretaria e prokurorisë përkëtbëse, në këto raste protokollon ekstremitetet e të dhënave të pasqyruara në zarf dhe zarfin e pahapur ia kalon vetëm prokurorit që i adresohet praktika.

7. Prokurori që ndjek procedimin, kërkesat/aktet e lidhura me përgjimin, të cilat i dërgon në gjykatë ose në institucione të tjera të autorizura, i mbyllë në zarf të vulosur ku shënon ekstremitetet e aktit (nr.prot, datën dhe institucionit që i drejtohet) dhe nëpërmjet sekretarisë ia dërgon gjyqtarit ose institucionit përkatës.

8. Gjatë procesit të përgjimit deri në përfundimit të tij, prokurori që ndjek çështjen ose oficeri i policisë gjyqësore i autorizuar prej tij mund të kërkojnë të njihet me rezultatet e përgjimit në dinamikën e këtij procesi dhe me kopje të të gjithë transkripteve të nxjerra.



9. Struktura e Përgjimit të Komunikimeve Elektronike ruan në Serverat e Sistemit të Përgjimit materialin përftuar gjatë përgjimit deri në kohën kur merr njoftim për asgjësimin e materjalit të urdhëruar nga gjykata, sipas rregullave që parashikojnë nenet 224 e 226/3 të K. Pr. Penale.

10. Prokurori që ka kërkuar përgjimin dhe çdo person tjetër që zotëron materialin e përgjuar është i detyruar:

- a) Të garantojë që materiali i jepet vetëm personave që kanë një kërkesë zyrtare për ta marr atë;
- b) Të sigurohet që personat që janë njohur dhe/ose u janë dhënë kopje të procesverbalit të transkriptit kanë nënshkruar si në regjistrin përkatës, ashtu dhe deklaratën për ruajtjen e sekretit dhe ndalimin e publikimit.

11. Administrimi, ruajtja, nxjerrja dhe asgjësimi i tij bëhet në zbatim nenit 223/4 e vijues të K. Pr. Penale, si dhe të këtij udhëzimi të përgjithshëm.

12. Ruajtja e sekretit në realizimin e përgjimit, që në momentin e inicimit të kërkesës për përgjim nga oficeri i policisë gjyqësore, deri në momentin kur bëhet lajmërimi i mbrojtësit apo përfaqësuesit të palëve për tu njohur me to, si dhe ndalimi i publikimit të materjaleve të përgjimit me vendim të arsyetuar të prokurorit, i cili sipas rastit mund ti dërgohet për zbatim edhe entit publike apo medias, janë mjete kryesor për arritjen e qëllimit në përmbushje të detyrimeve ligjore të parashikuara në nenet 103<sup>12</sup>, 104<sup>13</sup>, 279<sup>14</sup> të K.Pr.Penale dhe nenit 295/a<sup>15</sup> të K.Penal.

13. Në rastet kur konstatohet se personi fizik apo personi juridik (media) ose subjekti I procedimit ka zbuluar aktet sekrete të përgjimit ose të dhënat që përbajnë aktet apo pajisjet e përgjimit, duke mos u repektuar detyrimi për ruajtjen e sekretit apo ndalimin e publikimit të aktit sipas përcaktimeve në nenin 103 në lidhje me nenin 279 të K.Pr.Penale, drejtuesi i prokurorisë

<sup>12</sup> Shih, po aty, nenin 103 pika 2 që parashikon:

1. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve sekrete që lidhen me çështjen ose dhe vetëm i përmbajtjes së tyre nëpërmjet shtypit ose informacionit masiv.

2. Ndalohet publikimi, qoftë edhe i pjesshëm, i akteve josekrete deri në përfundimin e hetimeve paraprake.

<sup>13</sup> Shih po aty neni 104 "Shkelja e ndalimit të publikimit", që parashikon:

"1. Shkelja e ndalimit të publikimit e bërë nga nëpunësi i shtetit ose i një enti publik, kur nuk përbën vepër penale, është shkelje disiplinore. Në këtë rast prokurori njofton organin që ka të drejtë të marrë masa disiplinore."

<sup>14</sup> Shih po aty nenin 279 "Detyrimi për ruajtjen e sekretit" që parashikon:

1. Aktet hetimore janë sekrete derisa i pandehuri të mos ketë marrë dijeni për to. Në rast nevojë për vazhdimin e hetimeve prokurori mund të urdhërojë ruajtjen e sekretit për akte të veçanta deri në përfundim të hetimeve.

2. Prokurori mund të lejojë, me vendim të arsyetuar, publikimin e akteve të veçanta ose të pjesëve të tyre. Aktet e publikuara depozitohen në sekretarinë e prokurorit.

3. Edhe kur aktet nuk mbrohen më nga sekretin, sipas paragrafit 1, të këtij neni, në rastet kur është e nevojshme për vazhdimësinë e hetimeve, prokurori mund të disponojë me vendim të arsyetuar:

a) detyrimin e ruajtjes së sekretit për akte të veçanta, kur i pandehuri jep pëlqimin ose kur njohja e përmbajtjes së aktit mund të pengojë hetimet ndaj personave të tjerë;

b) ndalimin e publikimit të përmbajtjes së akteve të veçanta apo të dhënave të posaçme që lidhen me veprime hetimore tëaktuara.

<sup>15</sup> Shih neni 295/a § 3 të K.Penal "Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete", që parashikon:

"Zbulimi i akteve sekrete ose të dhënave që përbëjnë akte sekrete nga prokurori ose oficeri i policisë gjyqësore, si dhe mosrepektimi i detyrimeve të përaktuara në nenin 103 të K.Pr.Penale dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet."

kompetente (lëndore e tokësore) ose prokurori i autorizuar prej tij me marrjen dijani për veprën penale me iniciativën e vet duhet të regjistroj kryesisht procedimin penal për veprën penale të parashikuar nga neni 295/a § 3 i K.Penal, dhe të merren masat e duhura për kryejen e hetime dhe ushtrimin e ndjekjes penale ndaj subjektit/eve të posaçme dhe/ose ndaj personave përgjegjës, duke garantuar procesin e rregullt ligjor.

## Neni 12

### Mënyra e ruajtjes dhe asgjësimit të materjaleve të përgjimit

1. Pajisjet (CD, DVD, etj) ku janë regjistruar bisedat e transkriptuara në cilësinë e provës materjale, ruhen në vende të veçanta<sup>16</sup> (fashikullin e prokurorit) në prokurorinë që ka urdhëruar përgjimin dhe në serverat e Strukturës së Përgjimit të Komunikimeve Elektronike, derisa vendimi të marrë formë të prerë, me përjashtim të atyre që ndalohet përdorimi.

2. Kur pajisjet (CD, DVD, etj) ku janë regjistruar bisedat e transkriptuara nuk janë të nevojshme dhe mbi kërkesën e të interesuarit gjykata<sup>17</sup> që ka bërë vleftësimin e përgjimit vendos asgjësimin e tij, proces i cili realizohet nga prokurori që ndjek procedimin, nën kontrollin e gjyqtarit dhe për veprimin mbahet procesverbal.

3. Në rastet kur prokurori në përfundim të hetimeve që ka përdorur përgjimin i kërkon gjykatës pushimin e çështjes, në kërkesë duhet të njoftojë gjykatën edhe për asgjësimin e procesverbaleve dhe regjistrimeve, e cila kur pranon kërkesën për pushimin e çështjes vendos<sup>18</sup> edhe për asgjësimin e procesverbaleve dhe regjistrimeve në afatin e caktuar prej saj dhe vë në dijeni personin e përgjuar.

4. Në këto raste kur prokurori<sup>19</sup> vlerëson se njoftimi i personit mund të shkaktoj rrezik për jetën ose shëndetin e të tjerëve ose mund të vihet në rrezik një hetim i nisur, krahas njoftimit me shkrim ai i kërkon gjykatës që për këto arsye të mos bëhet njoftimi i personit të përgjuar dhe mbi këtë kërkesë vendosë gjykata.

5. Në çdo rast, asgjësimi i materialit të përgjimit kryhet në prani të një gjyqtari ose një personi tjetër të autorizuar për këtë qëllim. Gjyqtari ose personi i pranishëm vërtetojnë këtë fakt me procesverbalin e asgjësimit, një kopje e të cilës i dërgohet gjykatës dhe një kopje vendoset në fashikullin e hetimeve paraprake.

6 Materiali i përgjuar do të asgjësohet ose shkatërrohet fizikisht në mënyrat e parashikuara, si më poshtë:

<sup>16</sup> Shih po aty nenin 224 pika 1 dhe nenet 331 pika 4.

<sup>17</sup> Shih po aty nenin 224 pika 1.

<sup>18</sup> Shih po aty nenin 224 pika 2.

<sup>19</sup> Shih po aty nenin 224 pika 2.

a) Çdo material përgjimi i printuar digjet - shkrumbohet;

b) Çdo material përgjimi në formë elektronike i ruajtur në foldera-dosje në kompjuter ose server, fshihet.

c) Çdo material përgjimi i regjistruar në audio, fshihet dhe shkatërrohet.

7. Në rastet kur vendoset ruajtja e materialit të përgjuar, për faktin se rezultatet e tij mund të përdoren në procedime të tjera sepse janë të domosdoshme për hetimin e krimeve, në bazë të nenit 225 të K.Pr.Penale, procesverbalet dhe regjistrimet e përgjimeve depozitohen në organin tjetër që procedon ose në fashikullin e hetimeve për këto krime.

### **Neni 13**

#### **Përdorimi i rezultateve të përgjimit**

Përgjimi i bisedimeve, komunikimeve elektronike dhe i formave të tjera të komunikimit është i vlefshëm dhe i përdorshëm për të gjithë komunikuesit, dmth si për personin objekt përgjimi ashtu dhe për personat e tjerë që komunikojnë me të<sup>20</sup>.

### **Neni 14**

#### **Përdorimi i rezultateve të përgjimit në procedime të tjera.**

Rezultatet e përgjimit kanë vlerë dhe mund të përdoren për procedime të ndryshme, dmth në procedime të tjera, si përjashtim nga rregulli i përgjithshëm, por vetëm kur ato janë të domosdoshme për hetimin e krimeve<sup>21</sup>. Në këto raste, procesverbalet dhe regjistrimet e përgjimeve, i dorëzohen autoritetit tjetër që procedon.

### **Neni 15**

#### **Ndalimi i përdorimit**

1. Rezultatet e përgjimit nuk mund të përdoren kur janë bërë jashtë rasteve të lejuara nga ligji<sup>22</sup> ose kur nuk janë respektuar dispozitat e Seksionit IV "Përgjimet" të Kreut III të K.Pr.Penale.

2. Prokurorët duhet të bëjnë kujdes në vlerësimin e rasteve që ndalohet dhe nuk mund të përdoren rezultatet e përgjimit të bisedave ose komunikimeve, të cilët mund të jenë në rastet kur:

a) Përgjimet janë kryer jashtë rasteve të lejuara me ligj;

b) Nuk janë respektuar dispozitat e parashikuara në nenet 221-226 të K. Pr. Penale, për përgjimet;

<sup>20</sup> Shih po aty, nenin 221 pika 4 i ndryshuar.

<sup>21</sup> Shih po aty, nenin 225

<sup>22</sup> Shih, po aty nenin 226 në lidhje me kushtet e afatet e parashikuara nenet 221 pikat 1,2,3 dhe 222;

c) Personat që janë përgjuar kanë detyrim ligjor të ruajnë sekretin për shkak të profesionit ose detyrës<sup>23</sup>, si, përfaqësuesit e besimeve fetare, avokatët, noterët, përfaqësuesit ligjor, mjekët, farmacistët, etj, duke përjashtuar rastet kur këto persona kanë dhënë shpjegime për të njëjtat fakte, ose kur i kanë përhapur ato në ndonjë mënyrë tjetër<sup>24</sup>.

ç) Nënpunësit shtetërorë, nënpunësit publik që administrojnë fakte sekret shtetërorë<sup>25</sup>, duke përjashtuar rastet kur këto persona kanë dhënë shpjegime për të njëjtat fakte, ose kur i kanë përhapur ato në ndonjë mënyrë tjetër<sup>26</sup>.

3. Regjistrimet dhe procesverbalet e përgjimit që do të konsiderohen si të papërdorshëm, me urdhër të gjykatës në çfarë do gjendje apo faze të procedimit penal kryhet asgjësimi i tyre, me përjashtim të faktit kur këto përbëjnë provë materjale<sup>27</sup>.

## **Neni 16**

### **Pavlefshmëria absolute dhe/ose relative**

1. Prokurorët të verifikojnë vlefshmerinë e përgjimit të kryer në procedura normale ose në procedura të ngutëshme, duke vlerësuar respektimin e dispozitave përkatëse mbi përgjimin.

2. Përgjimi mund të jetë apsolutisht i pavlefshëm, në rastet kur:

a) Është kryer jashtë rasteve të lejuara me ligj;

b) Nuk janë respektuar dispozitat e parashikuara në këtë seksion, për përgjimin e bisedave ose komunikimeve sipas neneve 226/1-3 në lidhje me nenet 122, 128 e vijues të K. Pr. Penale.

3. Përgjime relativisht të pavlefshme mund të jenë në rastet kur evidentohen gabime materjale ose mungesa firme në regjistrin e përgjimeve që mban prokurori ose në procesverbalet e transkriptimit të oficerit të policisë gjyqësore sipas neneve 222, 223/2 e 129 të K. Pr. Penal

## **Neni 17**

### **Zbatimi**

1. Ky udhëzim i përgjithshëm është i detyrueshëm<sup>28</sup> për zbatim nga drejtuesit e prokurorive dhe prokurorët<sup>29</sup> e të gjithë niveleve të juridiksionit të përgjithshëm, si dhe nga oficerët e policisë gjyqësore dhe personeli i prokurorisë.

<sup>23</sup> Shih, po aty nenin 226 në lidhje me nenin 159;

<sup>24</sup> Shih po aty nenet 226, 52 pika 4, 159 e 160;

<sup>25</sup> Shih, po aty nenin 226 në lidhje me nenet 160 e 161;

<sup>26</sup> Shih po aty nenet 226, 52 pika 4, 159 e 160;

<sup>27</sup> Shih po aty neni 226 pika 3;

<sup>28</sup> Shih nenin 46 pika 1 e ligjit nr.97/2016;

<sup>29</sup> Shih po aty neni 6 pika 2;

2. Me mbikëqyerjen dhe zbatimin<sup>30</sup> e këtij udhëzimi të përgjithshëm ngarkohen Drejtoria e Përgjimeve të Telekomunikimeve dhe Marrëdhënieve me Shërbimet Informative në Prokurorinë e Përgjithshme dhe drejtuesit e prokurorive të juridiksionit të zakonshëm.

3. Drejtuesit e prokurorive mund të nxjerrin udhëzime të përgjithshme për lehtësimin e zbatimit<sup>31</sup> të këtij udhëzimi.

## Neni 18

### Hyrja në fuqi dhe publikimi

1. Ky udhëzim i përgjithshëm hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet<sup>32</sup> në faqen e internetit të Prokurorisë Përgjithshme.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi të përgjithshëm shfuqizohet urdhërimi nr.1 datë 21.04.2006 “Për përgjimet”, i ndryshuar.

## PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARTA MARKU



<sup>30</sup> Shih po aty nenin 38 pika 2 germa “b”, 42 germa “g”, 43 germa “dh”;

<sup>31</sup> Shih po aty nenin 46 pika 4, etj;

<sup>32</sup> Shih po aty nenin 46 pika 5;